



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:093017

Datë: 11.11.2020

Numri i dokumentit: 01264799

PKR.nr.307/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti për Krime Të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues - gjyqtarin Kujtim Krasniqi, me bashkëpunëtorin profesional Lavdim Mehmeti, në çështjen penale kundër të pandehurit R. B., për shkak të veprës penale Mashtrimi ne votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 te KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për krime të rënda, PP.I.nr.193C/2018, të datës 30.10.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 10.11.2020, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Shemsie Asllani, të akuzuarit R. B. me dt: 10.11.2020 mori dhe publikisht shpalli dhe me datë 11.11.2020 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: R. B., nga i ati Q., e ëma E., mbiemri i vajzërisë K., me nr. personal:, i lindur më dt., në T., K.G., tani me vendbanim te B....., i martuar, baba i 5 fëmijëve, i gjendjes së ulet ekonomike, i pa pune, laborant i kimisë, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Sepse, me date 12.12.2010, gjatë mbajtës se zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës se Kosovës, ne qendrën e vendvotimit 0306E/05D, ne shkollën fillore “Zenel Hajdini” ne fshatin Terstenik, K. e Gllogocit, te pandehurit A. B., Rr. D., F. B., N. G., E. G., R. B. dhe B. B., ne bashkëkryerje kane falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve ne Kosove, ne atë mënyrë qe me rastin e numërimit te votave te kandidateve brenda një subjekti politik, kane hequr votat disa kandidateve dhe kane shtuar kandidateve tjerë, duke i regjistruar ne mënyrë jo te saktë gjithsej 674 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) vota, dhe atë nga kandidatet e subjektit politike, AKR kane hequr dhe shtuar 9 (nëntë)vota, VV 2(dy) vota, AAK 11(njëmbëdhjetë)vota, dhe PDK 652 (gjashtëqind e pesëdhjetë e dy)vota,-

- **me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi ne votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 te KPK-së.**

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 41, 46, 73, 74 të KPRK-së, si dhe 248, 365 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

- Ashtu që të pandehurit R. B. i shqiptohet dënimi me burg me kohëzgjatje prej 6(gjashte) muajve, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë nëse në afat prej 1(një) viti nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.
- Në të kundërtën, gjykata në bazë të nenit 53 par.2 dhe 3 të KPPRK-së, revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar i shqiptohet dënimi unik për veprën penale të kryer më parë dhe veprën penale të re.
- **Obligohet;** i dënuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe atë; në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime Të Rënda ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr.193C/2018, të datës 30.10.2015, kundër të akuzuarit R. B. për shkak të veprës penale Mashtrimi ne votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 te KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 10.11.2020, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata i ka mundësuar të pandehurit pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pasi që në fillim të shqyrtimit fillestar, i pandehuri në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, ka pranuar fajësinë për veprën penale Mashtrimi ne votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 te KPK-së, gjykata në rastin konkret, lidhur me pranimin e fajësisë, pas marrjes së mendimit nga Prokurori i Shtetit, i cili është deklaruar që të aprovohet pranimi i fajësisë nga i pandehuri dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3 të KPPRK-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 248 par. 1, nën – par. 4 të KPPRK-së, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas pranimit të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes se kushteve në referim të nenit 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3, të KPPRK-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqyrtimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Me rastin e matjes dhe shqyrtimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 70 dhe 71 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që për të akuzuarin R. B. si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale, është penduar dhe

gjykatës i ka premtuar se nuk do të përsëris vepra të tilla, si dhe është i sëmurë me tomor, nuk është i punësuar, baba i 5 femijeve dhe i vetmi person qe kujdeset për familjen ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, dhe nisur nga të gjitha këto të thëna gjykata i shqiptoi dënim me gjobë me bindje se në rastin konkret është adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi me gjobë i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par.2 të KPRK-së, me shkallën dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 248 dhe 365 par.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
 Departamenti për Krime të Rënda
 PKR.nr.307/16, dt.11.11.2020

B. Profesional,
 Lavdim Mehmeti

Kryetari i trupit gjykues- Gjyqtari,
 Kujtim Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.